



Green School Sh.p.k

Shkolla 9-vjecare

Eurolingua

PAKETE INFORMATIVE PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Institucioni arsimor “Green School” Tiranë, është një institucion jo publik i cili ofron arsimin 12-vjeçar nga cikli parashkollor deri në klasën e nëntë. Ky institucion është i hapur për të gjithë fëmijët e kësaj moshe, pa dallim përkatësie gjinore, fetare apo etnike. “Green School” do të punojë në bazë të programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës si dhe programeve tjera shtesë në përputhje me metodologjinë e shkollës.

Sistemi Arsimor Parashkollor

Shkolla jonë krijon një mjedis të ngrohtë e mikëpritës për të gjithë nxënësit e saj të rinj. Pasi personat e interesuar njihen me të gjitha rregullat dhe modalitetet e institucionit, pranimi në shkollë bëhet nëpërmjet një takimi me familjen dhe një testi vlerësues me praninë e një psikologu në raste specifike.

Ky institucion është i hapur për të gjithë fëmijët e kësaj moshe, pa dallim përkatësie gjinore, fetare apo etnike.

“Green School” do të punojë në bazë të programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Oraret

- Prindërit janë të lutur të sjellin fëmijët në oraret e caktuara për të mos prishur mbarëvajtjen e mësimi.
- Për çdo mungesë apo vonesë, prindërit duhet të lajmërojnë në kohë drejtuesen e kopshtit.
- Për një funksionim sa më të mirë të procesit mësimor, prindërit janë të ndaluar të futen në ambientet mësimore.

Institucioni

- “Kopshti i Gjellbër” është i detyruar të sigurojë të gjithë bazën materiale për mbarëvajtjen sa më të mirë të procesit mësimor.
- Kopshti siguron kushtet optimale të godinës së tij ku do të ushtrohet aktiviteti.
- Për çdo rast aksidenti, sëmundje apo dëmtime të fëmijëve kopshti njofton menjëherë prindërit.
- Kopshti i jep çdo prindi në prag të fillimit të vitit shkollor listën e sendeve personale që çdo fëmijë duhet të sjellë me vete.
- Kopshti mban në përdorim një kuti të ndihmës së shpejtë në raste dëmtimesh të

